



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 19.05.2025

PROJEKT - VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR
SHTETASIN FATOS MYFTARI”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.5, datë 07.02.2025 “Për miratimin e detajimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025, për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin **Fatos Myftari**, Kryetari I Bashkisë:

PROPOZON

1. Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shtetasin Fatos Myftari.
2. Vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administratë, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

Ju faleminderit!

KRYETARI
ADRIATIK MEMA



Përgjegjëse NE dhe PAK-së
Teuta HYSENBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore
Rudina LLANGO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN FATOS MYFTARI
BANOR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasi **Fatos Myftari** më datë **18.05.2025**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikat 1, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me *NR.5, datë 07.02.2025*, për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj për vitin 2025 :

JU RELATOJ:

Familja e shtetasit Fatos Myftari me banim në qytetin e-Çorovodës, Bashkia Skrapar, përbëhet prej 2 anëtarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.

Z.Fatos Myftari prej vitesh ka shfaqur probleme të theksuara me veshkat. Shkon tre herë në javë në qytetin e Beratit për të bërë dializë. Trajtohet si invalid pune, pagesa që merr nga invaliditeti nuk mjafton për të përballuar jetesën dhe shpenzimet për të ndjekur trajtimet mjeksore që kushtojnë pasi dhe bashkëshortja është e pa punë.

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e Z. Fatos Myftari Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasit Fatos Myftari

**Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së
Teuta Hysenbelliu**

